# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE IKRTK
# TETOR 2024 – DHJETOR 2024

| **Nr. Rendor** [1] | **Data e kërkesës**[2] | **Objekti i kërkesës**[3] | **Data e përgjigjes**[4] | **Përgjigje**[5] | **Mënyra e përfundimit të kërkesës**[6] | **Tarifa**[7] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | 08.10.2024 | Kërkesë për bashkëpunim nga Shoqata Kulturore Atdhetare P....., Shkodër mbi procedurat e regjistrimit të objekteve muzeore. | 19.11.2024 | Autorizim shërbimi për pranë ambienteve të muzeut Postribë. Në zbatim të ligjit 27/2018"*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", mbi procedurat e regjistrimit në Bazën e të Dhënave Shtetërore *“Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”,* | E plotë | S’ka |
| 13 | 29.10.2024 | Kërkesë për informacion mbi lejen e zhvendosjes për veprat e artit.<br>A. S | 29.10.2024 | Në përgjigje të email-it tuaj, ju informojmë se Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK) kryen procedurat ndërmjet e-albania, në rastet kur vepra/objekti lëviz jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Vërtetimi i lëshuar nga IKRTK nuk vlen për shitjen e objektit, por vetëm për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.<br>Për tu pajisur me vërtetimin, ju duhet të Aplikoni në portalin e-Albania sipas hapave të mëposhtëm:<br>1. Identifikohuni si individ ose subjekt në portalin e-Albania;<br>2. Zgjidhni shërbimin "Aplikim për regjistrim, si dhe Aplikim për leje zhvendosje të veprave të artit";<br>3. Klikoni butonin "Përdor";<br>4. Plotësoni formularin e aplikimit dhe ngarkoni dokumentacionin përkatës;<br>Më pas kërkesa juaj do të procedohet nga IKRTK dhe vërtetimin mund ta shkarkoni nga e- Albania.<br>Bashkëlidhur do të gjeni linkun, ku shpjegohet me anë të një video ilustruese mënyra e kryerjes së aplikimit: https://www.youtube.com/watch?v=UCDlPnaPDvQ<br>Në zbatim të ligjit 27/2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", pajisja me këtë vërtetim shërben për veprat të cilat do të lëvizin jashtë territorit shqiptar dhe që nuk janë krijuar më shumë se 50 vjet më parë. | E plotë | S’ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | 04.12.2024 | Kërkesë për informacion nga Znj. A. F | 05.12.2024 | Në përgjigje të email-it tuaj, datë 03.12.2024 "*Kërkesë për informacion*" lidhur me kërkesën për pajisjen me hartën e monumenteve dhe pasaportat e objekteve në Bashkinë Elbasan, ju bëjmë me dije se:<br>Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK), nuk është administrues i hartës së monumenteve.<br>Në zbatim të ligjit 27/2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", IKRTK ka kryer procedurat e verifikimit në Bazën e të Dhënave Shtetërore *"Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)*, ku sipas vendndodhjes Elbasan rezultojnë 83 objekte të trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme, prej të cilave 40 objekte në pronësi shtetërore dhe 43 banesa në posedim të personave privat.<br>Në zbatim të ligjit Nr.119/2014 '*Për të drejtën e informimit'* si dhe Udhëzimit Nr. 47 datë 14.9.2018, "*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*", për 43 objektet në posedim të personave privat nuk mund t'ju vendosim në dispozicion pasaportat e objekteve. | E plotë | S'ka |

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
[2] Data e regjistrimit të kërkesës
[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[4] Data e kthimit të përgjigjes
[5] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[6] Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.